



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2142/1 Prot

Tiranë, më 24/07/2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

KËTU

DREJTORISË RAJONALE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE DIBËR

Në zbatim të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.66, datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirim të detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”, dhe shkresës nr.371 prot., datë 19.06.2023 “Kërkesë për shpallje vendi të lirë pune” të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Dibër, protokolluar në AKPA me nr.2142 prot, datë 21.06.2023, ju lutem procedoni me shpalljen e njoftimit për vendin e lirë në faqen elektronike zyrtare të AKPA-s si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Dibër, brenda datës 25.07.2023, si më poshtë:

Pozicioni i punës:

Specialist në Sektorin e Menaxhimit e Ofrimit të Shërbimeve të Punësimit, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Dibër (vetëm për periudhën kohore të lejes së barrë lindjes së specialistit të emëruar në këtë pozicion).

1. Kriteria të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

2.Kritere të posaçme:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare “Bachelor”;
- b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;
- c) të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe /ose të gjuhëve të tjera (preferohet);.

3. Dokumentet e aplikimit:

- a. letërmotivimi për pozicionin;
- b. jetëshkrimin (CV-në), i cili plotësohet sipas formatit në shtojcën nr.1 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15, datë 29.04.2022 “Për mënyrën e emërimit dhe të lirimit nga detyra të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive që trajtohen me Kodin e Punës”
- c. kartën e identitetit;
- d. diplomën dhe listën e notave;
- e. librezën e punës (nëse ka eksperiencë pune);
- f. çdo dokumentacion tjetër, që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (nëse ka);
- g. certifikatë/a ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h. vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j. vërtetim nga punëdhënësi i fundit ,që nuk ka masë disiplinore në fuqi (nëse ka eksperiencë pune);
- k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm (nëse ka eksperiencë pune);

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinal ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Njoftimi bëhet në faqen elektronike zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Dibër.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të Drejtorisë Qëndrore të AKPA-s, brenda datës 04.08.2023.

Struktura e vlerësimit të kandidatëve fitues në fazën e dytë është si më poshtë:

- Vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë në:

i. arsimimi : 20 pikë;

ii. njohuritë në fushën e TIK- ut : 20 pikë;

-Vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;

-Komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca , për të gjithë kandidatët;

-Në intervistë, ndër të tjerat, kandidati vlerësohet për:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

- a) Njohuritë e përgjithshme mbi kuadrin ligjor në fushën e punësimit , mbi të cilin rregullohet dhe organizohet fusha e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- b) Ligji nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit";
- c) Ligji nr.45/2016 "Për Vullnetarizmin";
- d) VKM nr.17, datë 15.01.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", i ndryshuar;
- e) VKM nr.348, datë 29.04.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit", i ndryshuar;
- f) VKM nr.535, datë 08.07.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet";
- g) VKM nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar
- h) VKM nr.161, datë 21.03.2018 "Për pagesën e së ardhurës nga papunësia", i ndryshuar;
- i) VKM nr.837, datë 28.10.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për Ofrimin e Shërbimeve të Punësimit" i ndryshuar;
 - i. motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;
 - Komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve.
 - Minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klevis HYSA

